



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 71/16
Prishtinë, më 26.10.2016, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Shukri Buja, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Shqipe Pantina, Bali Muharremaj Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić dhe Bardhyl Meta.

Pjesëmarrës të ftuar: Ymer Havolli - kryesues i FKPK-së, Ruzhdi Morina – anëtar i Bordit të FKPK-së, Vërshim Hatipi - zv. Drejtor në FKPK, Ismet Krasniqi – Sekretar i Kuvendit, Ismet Krasniqi - Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës, Emrush Haxhiu dhe Istret Azemi nga Administrata e Kuvendit të Kosovës.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Sahit Troshupa nga RTV-21, Fjolla Uka - monitoruese nga KDI, Etleva Moloshi- Asistente e GP VV, Florina Ejupi - monitoruese nga BIRN, Albulena Nuha - gazetare nga RTV-21, Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2017;**
3. **Shqyrtimi i kërkesës për përcaktimin e pagës së Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it;**
4. **Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2017 -2019, në bazë të qarkorës së dytë buxhetore të Ministrisë së Financave 2017/02;**
5. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari – konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2017

Kryetari – Bordi i Fondit Pensional për vitin 2017 ka paraparë të menaxhojë 1 miliard e 394 milion e 600 mijë euro, kthimi i investimeve do të jetë 3%, tërheqja 21.6 milion euro. Fondi në kërkesën drejtuar në Kuvend, që për vitin 2017, ka propozuar të miratohet taksa operationale prej 0.082% dhe taksa investive 0.393%.

Ymer Havolli – kërkesa për miratimin e taksave menaxhuese është prej 0.475%, që është më e ulët që nga themelimi i Fondit.

Kryetari - theksoi se kemi nevojë për sqarime dhe arsye të shtesë në dokumentin e dorëzuar nga Fondi. Ju keni propozuar taksën operationale prej 0,082% si në vitin e kaluar, ndërkaq vlera e mjeteve nën menaxhim është rritur mbi 200 milion euro?

Vërshim Hatipi - mjetet janë rritur, por taksa operative është e ulët e cila nuk përkthehet në mjete si total. Kjo taksë do të realizohet prej shumës 1 miliard e 225 milion euro, pasi që Fondi ka realizuar të hyra nga aktivitetet operationale dhe ka pasur një deficit operacional.

Kryetari – në planifikimin e shpenzimeve për anëtarët e bordit, buxheti duhet të jetë për 7 anëtar, pasi që me Prjektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Fondet Pensionale, që e kemi amendamentuar, kemi propozuar që mos të kompensohet pjesëmarrësi i qeverisë si anëtar i bordit sipas detyrës zyrtare. Sigurimi fiduciar ka rritje për 8.2%.

Vërshim Hatipi – me rritjen e aseteve nën menaxhim, rritet edhe kostoja e shpenzimeve. Sigurimi fiduciar për anëtarët e bordit përcaktohet në bazë të çmimit të tregut. Sa i përket shpenzimeve për sigurimin shëndetësor, kemi planifikuar duke u bazuar në Ligjin për sigurimet shëndetësore, që pritet të hyjë në fuqi nga 1 janari i vitit të ardhshëm.

Besa Gaxherri – nëse analizojmë buxhetin për investime, shohim se ka do të ketë rritje krahasur me këtë vit. Përderisa në vitin e kaluar e keni menaxhuar fondin investiv me ato mjete në dispozicion, na jepni arsyetimin pse këtë vit nuk po mundeni me menaxhu? Sa i përket buxhetit operacional, krahasur me vitin e kaluar kemi rritje të shpenzimeve në disa pozicione. Shpenzimet e bordit nga 197,017 euro sa ishin në vitin 2016, parashikohen 211,582 euro, kompenzimet e anëtareve të bordit i keni parashikuar me rritje për 7%. Sigurimi fiduciar po ashtu me rritje për 8.3%.

Një çështje që duhet sqaruar është pozicioni i shpenzimeve “puna e komisioneve të bordit” prej 28,000 euro, pse duhet të jetë kjo shumë, kur anëtarët e bordit marrin rrogë për punën që e bëjnë. Sa i përket shpenzimeve të personelit, për 29 pozita i keni planifikuar 472,806 euro dhe në bazë të llogaritjeve del se paga mesatare është 1,360 euro. Kontributet pensionale dhe për shëndetësi i keni rritur për 40.5%. Keni planifikuar edhe koston e kontratës kolektive prej 35,168 euro, ndërsa në të njëjtën kohë keni planifikuar shpenzime tjera si: për punët jashtë orarit 5,630 euro, trajnime 9,390 euro dhe shpenzime tjera të stafit 2,240 euro.

Enver Hoti – do të ishte mirë të na sjellni një kopje të kontratës kolektive për të parë se çfarë përmban ajo kontratë.

Shukri Buja – në materialin e prezantuar, po shoh dy pozicione të shpenzimeve për sigurimet shëndetësore. Po ashtu pozicioni për kontributet pensionale është paraparë dy herë. Do të ishte mirë të sqarohen këto shpenzime para se me procedurë kërkesën në Kuvend.

Shipe Pantina – nga planfikimi i shpenzimeve po shifet se për sigurimet shëndetësore janë dy pozicione, dhe duhet të jetë ose njëra ose tjera. Ndërkaq, në anën tjetër në lidhje me pagat, vërejtjet më të mëdha që merr Trusti është se drejtori menaxhues është njeriu më i paguar në sektorin publik e mos të flas për sektorin privat dhe është mirë me diskutue njëherë dhe me pas një përgjigje të pranushme, për deputetët dhe për publikun.

Përveç kësaj, unë kam edhe dy pyetje: tek pozicioni “Mardhëniet me publik dhe korrespondenca”, raportimi tek kontribuesit është shumë i shtrejtë. Unë do të isha pajtuar me këtë shumë nëse raportet do të shpërndanit përmes Postës, që edhe ashtu kanë probleme financiare. Në këtë drejtim unë mendojë se informimi i kontribuesve mundet të bëhet përmes formave tjera më kreative dhe metodave të teknologjisë informative. Tek shpenzimet kontigjente, çfarë keni paraparë, pasi që keni planifikuar një shumë të caktuar të mjeteve rezervë? Tek amortizimi a keni blerë paisje tjera apo keni mjete më pak, qfarë është kjo shumë?

Vërshim Hatipi – sa i përket amortizimit i kemi blerë paisjet para sa kohe dhe ato duhet me u zhvlerësu dhe i kemi paraqit si shpenzime kapitale.

Ruzhdi Morina – taksa rritet me rritjen e mjeteve nën menaxhim sepse rriten shpenzimet për aset menaxherët.

Ymer Havolli - përqindja e taksave është si në vitin e kaluar, por ka pas edhe suficit. Shpenzimet operacionale kanë mbetur të njëjta dhe në total buxheti është i njëjtë. Ndërkaq për mjetet investive, me rritjen e tyre rriten edhe shpenzimet për mjetet shtesë.

Kryetari - krahasur me vitin e kaluar shuma e mjeteve nën menaxhim është më e madhe. Si ka mundësi që taksa me qenë e njëjtë?

Vërshim Hatipi – dallimi është se ne do të fillojmë vitin me një suficit dhe llogaritja bëhet në mjetet mesatare nën menaxhim shumëzuar me taksën.

Ruzhdi Morina – pagat për tetë anëtar të bordit është bërë në bazë të projektligjit. Nëse komisioni ka propozuar me heq kompensimin për anëtarin e qeverisë, atëherë shuma mund të zbritet. Po ashtu sigurimi shëndetësor mund të hiqet. Sa i përket pagesës së komisioneve bëhet në formë të mëditjeve dikun 100 euro për mbledhje.

Kryetari – anëtarët e bordit marrin pagën për mbledhjet që mbajnë. Pyetja është se qfarë është shuma prej 9,400 euro për punën e komisioneve të bordit?

Ymer Havolli – kërkesa e Bankës Qendrore është se duhet të mbahen mbledhjet e komisioneve të bordit dhe këto konsiderohen punë shtesë. Komisionet i mbajnë deri në katër mbledhje në vit.

Kryetari – propozojë që të bëhen ndryshimet në buxhetin për shpenzime operacionale: të zbritet paga, kontributet pensionale dhe shëndetësore për anëtarin e bordit të caktuar nga Qeveria, të heqet sigurimi shëndetësor, sigurimi fiduciar të mbetet si në vitin 2016. Si rrjedhojë zbritet edhe përqindja e taksës operacionale.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni, unanimisht nxori këtë

Rekomandim

1. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për caktimin e taksës operationale prej 0,081% dhe taksës investive prej 0,393%, për vitin 2017.

2. Shqyrtimi i kërkesës për përcaktimin e pagës së Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it

Krytari - me miratimin e Ligjit të ri për energjinë elektrike, për Ndërmarrjen Publike KOSTT, është ndryshuar pronësia nga Qeveria në Kuvend. Po ashtu është përcaktuar që kryesuesin dhe anëtarët e Bordit të Drejtorëve të këtij Operatori të zgjidhen nga Kuvendi, si dhe pagat e tyre dhe për pagat për komisionin e auditimit të caktohet nga Kuvendi. Unë kam marrë një krahasim të pagave të institucioneve të gjashme, si të ZRRE-së, KPMM-së dhe ARKEP-it. Unë mendojë se duhet ti krahasojmë me pagat e bordit të ARKEP-it. Për kryesuesin e Bordit paga të jetë 1,550 euro, ndërsa për anëtarët 1,350 euro. Po ashtu propozjë që kryesuesin e komisionit të auditimit të caktohet kompensimi prej 120 euro për mbledhje dhe 100 euro për anëtarët e komisionit, të cilët mund të kompensohen më së shumti për gjashtë mbledhje në vit.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni, unanimisht nxori këtë

Propozim – Vendim

Për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe të kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit të Auditimit, të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh.a.

1. Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh.a., i caktohet paga në shumën prej 1,550 euro, bruto në muaj.
2. Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh.a., i caktohet paga në shumën prej 1,350 euro, bruto në muaj.
3. Kryesuesit të Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh.a., i caktohet paga në shumën prej 120 euro bruto, për pjesëmarrje në një mbledhje.
4. Anëtarëve të Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh.a., i caktohet paga në shumën prej 100 euro bruto, për pjesëmarrje në një mbledhje.
5. Pagat për kryesuesin dhe anëtarët e Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh.a., sipas pikave 3 dhe 4 të këtij propozim-vendimi, paguhen më së shumti për pjesëmarrje në 6 (gjashtë) mbledhje brenda një viti.
6. Niveli i pagës së Kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe i kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit të Auditimit, sipas pikës 1 deri në 5 të këtij Propozim-vendimi, bëhet nga buxheti i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh.a., dhe zbatohet deri në miratimin e Ligjit përkatës për pagat e funksionarëve të lartë publikë.

3. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2017 -2019, në bazë të qarkorës së dytë buxhetore të Ministrisë së Financave 2017/02;

Ismet Krasniqi - qarkorja e dytë është si rrjedhojë e qarkorës së parë. Gjatë kësaj kohe ka pas disa ndryshime dhe Ministria e Financave i ka caktuar kufijtë dhe prap nuk ka marrë parasysh kërkesat Kuvendit. Për programin stafi mbështetës politik, për mallra e shërbimeve kemi një buxhet prej 60,000 euro për auditimin e partive politik. Deri më tani i kemi pasur tre tender dhe aplikuesit janë tërhequr nga interesimi, pasi që shuma e buxhetit ka qenë e vogël dhe propozimi është që të rritet shuma në 120,000

euro, pasi që rritet nevoja për auditimin e partive politike. Janë paraparë 16 pozita të reja dhe buxheti shtesë prej 126,244 euro. Prej tyre janë 6 pozita analista ligjor me vendim të Kryesisë. 60,000 euro shtesë për mallra dhe shërbime për stafin mbështetës, këshilltarët, asistentat, vozitësat dhe 15,000 euro për kompensimin e praktikantëve, që për një kohë kemi pasur mbështetje prej NDI dhe organizatave tjera, por tani duhet ti bëjë Kuvendi. Sa i përket projekteve kapitale jemi brenda kufijëve të përcaktuar nga Ministria financave.

Shqipe Pantina - kam dy pyetje: subvencionet dhe transferet janë rritur vazhdimisht. Përderisa në vitin 2014 dhe 2015 kanë qenë 6,800 euro, në vitin 2016 janë rritur 120,000 euro dhe tani po kërkohen 140,000 euro. Unë jam kundër që e gjithë kjo shumë të jetë për subvencione dhe transfere. Qështje dytë ka të bëjë me Ligjin për sigurimet shëndetësore, i cili pritet të hyjë në fuqi vitin e ardhshëm, ndërsa nuk është planifikuar buxhet nga Kuvendi?

Ismet Krasniqi - sqaroi se shpenzimet për subvencione dhe transfere janë për shpenzimet e paparashikuara. Sa i përket sigurimeve shëndetësore, mandatin e kaluar ne i kemi planifikuar, por me rekomandimet e këtij komisioni i kemi hequr. Ner nuk i kemi planifikuar sigurimet shëndetësore, pasi që Ligji për sigurimet shëndetësore, nuk ka ndonjë udhëzim për të treguar se si do të implementohet ligji.

Shukri Buja – theksoi se në emër të grupit parlamentar, kërkojmë që kërkesat e Kuvendit të përkrahen ashtu siç kanë qenë në të miratuara në qarkoren e parë buxhetore, pa ndryshime. Në të kundërtën, ne nuk do ta përkrahim buxhetin.

Pas votimi, kryetari konstatoi se Komisioni nuk e përkrahu planifikimin e shpenzimeve për subvencione dhe transfere në shumë prej 140,000 euro. Ndërsa kërkesat tjera u përkrahen, siç janë përgaditur nga Administrata e Kuvendit.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni nxori këtë

Rekomandim

- I. I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit, të miratojë kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2017-2019, sipas dokumentit të bashkangjitur këtij rekomandimi dhe Kryesia t'i rekomandojë Ministrisë së Financave, që të njëjtat kërkesa, ti përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017-2019.

Mbledhja përfundoi në ora 12:20

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani